



KUVENDI I KOMUNËS SË MITROVICËS VERIORE

Nr. _____

Data: 07.05.2025

Mitrovicë Veriore.

Në mbështetje të nenit 12, paragrafi 2, shkronja (d), neni 17 shkronja (c) dhe neni 40 të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr.28/2008"), neni 10, paragrafi 10.2, të Ligjit Nr.02/L-26, për Tokat Bujqësore, neni 6 paragrafi 6.2, neni 8, paragrafi 8.4 të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006, për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore, neni 2, neni 10 paragrafi 1 dhe 2, Statutit të Komunës Nr.10-030/01-0007269/24 të datës 28.06.2024, kërkesës Nr.04-030/01-0003457/25 të datës 06.03.2025, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelës P-73808131-00221-7 dhe parcelës P-73808131-00221-8, të evidentuara në Zonën Kadastrale Suhodoll i Epërm, Mitrovicë Veriore, në pronësi të përbashkët të Basri Sejdiu dhe Qefsere Sejdiu, Kuvendi i Komunës së Mitrovicës Veriore në Mbledhjen e mbajtur me datë 07.05.2025 merr këtë:


V E N D I M

Paraparak për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore

1. **Miratohet** Propozimi i Kryetarit të Komunës Nr. 04-030/01-0003457/25 i datës 24.03.2025 dhe merret vendimi paraparak për ndërrim destinim të tokës bujqësore në tokë ndërtimore të parcelave kadastrale P-73808131-00221-7 dhe P-73808131-00221-8, në sipërfaqe të përgjithshme prej 754,00 m², tokë e klasës së 5-të në vendin e quajtur "Pusa", të evidentuara në Zonën Kadastrale Suhodoll i Epërm, Komuna Mitrovicë Veriore, në pronësi të përbashkët të ~~Basri Sejdiu~~ dhe ~~Qefsere Sejdiu~~.
2. Sipas pikës 1 të këtij vendimi, toka me destinim bujqësor, parcelat kadastrale P-73808131-00221-7 dhe P-73808131-00221-8, në sipërfaqe të përgjithshme prej 754,00 m², në vendin e quajtur "Pusa", të evidentuara në Zonën Kadastrale Suhodoll i Epërm, Komuna Mitrovicë Veriore, në pronësi të përbashkët të ~~Basri Sejdiu~~ dhe ~~Qefsere Sejdiu~~, **destinohet tokë ndërtimore**.
3. Kompensimi për ndërrim destinimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore sipas pikës 1 dhe 2 të këtij vendimi do të paguhet në procedurë administrative të marrjes së lejes së ndërtimit sipas dispozitave të nenit 14, paragrafi 14.2, shkronja **a** dhe **b** të Udhëzimit Administrativ Nr. 41/2006, për Ndërrimin e Destinimit të Tokës Bujqësore.
4. Obligohet pronari që paluajtshmerinë për ndërrim destinim ta shfrytëzoj sipas kërkesës së parashtruar.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset, Kryetari i Komunës dhe Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Gjeodezi.

6. Pas miratimit nga Kuvendi i Komunës së Mitrovicës Veriore, ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës dhe 7 ditë pas shpalljes publike në ueb-faqen e Komunës.

Mitrovicë Veriore

Nedžad UGLJANIN

Kryesues i Kuvendit në Komunën e Mitrovicës Veriore

